



### Konferenca e 3-të Ndërkombëtare e Fakultetit të Shkencave të Edukimit në UE

Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" mbajti me sukses Konferencën e 3-të Ndërkombëtare me temë "Globalizimi dhe Integrimi në Edukimin Bashkëkohor". Në fjalën e tij përshëndetëse rektori i universitetit, Prof.dr. Skender Topi, shprehu vlerësimin për angazhimin dhe organizimin e konferencave shkencore, duke u kthyer në promotor të shumë iniciativave, përfshirë këtu projekte të shumta të fituara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një shëmbull i shkëlqyer i këtyre iniciativave është edhe pjesëmarrja e gjerë e profesorëve brenda dhe jashtë vendit, duke treguar kështu edhe njëherë që largësia nuk pengon zhvillimin e bashkëpunimit kur si qëllim është arsimi. Kjo konferencë e organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit, shërben si një platformë për studies, kërkues, akademikë dhe profesionistë nga e gjithë bota, për të bashkëndajné ide, perspektiva dhe këndvështrime të reja, duke kontribuar në zhvillimin e njohurive shkencore në fushën e edukimit.

### Histori suksesi në UE



Denis Korreshi i diplomuar në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", një histori suksesi dhe frymëzimi për të gjithë studentët tanë. Denis Korreshi është diplomuar në programin e studimit "Teknologjitë e informacionit" në Universitetin e Elbasanit dhe ne një takim me studentët zgjodhi të ndaje eksperiencën e tij si student, si përfitues i programit Erasmus +, të ofruar nga institucioni ynë dhe karrierën e tij të suksesshme, si specialist i nivelit Cyber Security Senior, pranë bankës HSBC UK, Katowice, Poloni.

### Konstituimi i Këshillit Studentor në UE



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua mbledhja për Konstituimin e Këshillit Studentor, pas zhvillimit të procesit zgjedhor për Këshillin Studentor, me përfaqësues nga këshillat studentor të fakulteteve, Komisioni Institucional Zgjedhor dhe Komisioni Apelimit Studentor.



# DITARI MUJOR

Dhjetor 2023

## Takim me përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit

Drejtues të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në datën 4 dhjetor 2023, zhvilluan një takim me Komisioneren e Seksionit të Përgjithshëm pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, Znj. Vilma Shurdha, e shoqëruar nga ndihmëskomisionerja që mbulon problemet e arsimit pranë këtij institucioni. Zëvendësrektori i Universitetit, Prof.as.dr. Peçi Naqellari, informoi të pranishmit mbi universitetin, programet e studimit dhe strukturat që vihen në dispozicion për studentët. Ai u përqendrua në problematikat dhe shqetësimet që kanë sot institucionet e arsimit të lartë. Në përfundim të takimit Znj. Vilma Shurdha, zhvilloi një takim me studentë, me qëllim informimin mbi rolin dhe funksionin e institucionit të Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.



## Universiteti i Elbasanit merr pjesë në Festivalin Skills Careers and Jobs

Universiteti i Elbasanit pjesëmarrës në Festivalin Skills Careers and Jobs, organizuar nga AlbanianSkills me mbështetjen e Expocity Albania. Universiteti i Elbasanit u përfaqësua nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, të cilët diskutuan dhe ndanë eksperiencën e tyre në fushën e këshillimit të karrierës, aktivitetet që zhvillohen me studentët, lidhjet e forta që ruajmë me alumnin tonë, por sigurisht duke cilësuar edhe sfidat që na presin në të ardhmen. Në përfundim të Panelit tematik 4 : Edukim dhe udhëzim për karrierë; Zhvillimet dhe sfidat, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, ftoi studentët dhe nxënësit që ishin pjesëmarrës në këtë aktivitet, që të vizitojnë Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe të përzgjedhin nga larmishmëria e programeve të studimit, shërbimeve, mundësive dhe aktiviteteve që ofrojmë.



## Universiteti i Elbasanit zhvilloi procesin e zgjedhjeve për Këshillin Studentor

Në mjediset e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" u zhvillua procesi i zgjedhjeve për Këshillin Studentor, me një pjesëmarrje të gjerë të studentëve nga të gjitha fakultetet.

